

**MASË ZBATUESE NË PAJTIM ME NENIN 12 TË MARRËVESHJES NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EUROPIAN MBI PROCEDURAT E SIGURISË PËR SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

HYRJE

1. Në pajtim me Nenin 12 të Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Europian (BE) dhe Republikës së Shqipërisë mbi procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar ('Marrëveshja'), standardet për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet BE-së dhe Republikës së Shqipërisë ('Palët') parashikohen në këtë Masë Zbatuese të vendosur nga autoritetet kompetente të sigurisë.
2. Autoritetet kompetente të sigurisë referuar në paragrafin 1 ('Pjesëmarrësit') janë:
 - a. për Bashkimin Europian:
 - i. Drejtoria e Sigurisë dhe Sekretit e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të BE-së (GSDCSS),
 - ii. Drejtoria e Sigurisë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore dhe Sigurisë së Komisionit Europian (DG.HR.DS), dhe
 - iii. Drejtoria e Sigurisë dhe Infrastrukturës së Shërbimit të Jashtëm të Veprimit Europian (EEAS.BA.SI), dhe
 - b. për Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)

SHENJIMET E KLASIFIKIMIT DHE DEKLARUESHMËRISË

3. Zbatohen nivelet e klasifikimit siç përcaktohen në Nenin 7 të Marrëveshjes.
4. Përveç shënjimeve të klasifikimit, informacioni i shkëmbyer në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të përfshijë një shenjim specifik të deklarueshmërisë, si:

SECRET UE/EU SECRET

I DEKLARUESHËM PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

ose

(SEKRET)

I DEKLARUESHËM PËR BE-në

5. Informacioni i klasifikuar mund të ketë shënjime shtesë ('kushte' ose 'tregues'), p.sh., për të treguar fushën e aktivitetit me të cilën ka të bëjë, identifikojë burimin fillestar, kufizojë shpërndarjen ose kufizojë përdorimin.

SIGURIA PËR PERSONELIN

6. Secila Palë do të identifikojë, në administratën e saj përkatëse, ato pozicione që mund të kërkojnë akses në informacionin e klasifikuar, në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret.
7. Në pajtim me Nenin 5(e) dhe (g) të Marrëveshjes, aksesit tek informacioni i klasifikuar do tu jepet vetëm individëve që kanë 'nevojë-për-njohje' dhe që janë vënë në dijeni në lidhje me përgjegjësitë e tyre. Ata do të konfirmojnë gjithashtu me shkrim që ata janë në dijeni të rregullave dhe procedurave përkatëse të sigurisë dhe që çdo shkelje e tyre mund të rezultojë në masë disiplinore dhe/ose masa të tjera të mundshme ligjore në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të Palës përkatëse.
8. Në pajtim me Nenin 8(1) të Marrëveshjes, individët që kanë akses në informacionin e klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL dhe më lart duhet të ketë lejen e sigurisë tek niveli i kërkuar ose përndryshe i autorizuar rregullisht në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.
9. Për këtë qëllim:
 - a. për BE-në, GSCDSS-ja, HR.DS-ja e Komisionit dhe EEAS.BA.SI-ja janë përgjegjëse për tu ndërlidhur me Autoritetet e Sigurisë Kombëtare (NSA) ose autoritete të tjera kompetente kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së, për të siguruar që hetimet e sigurisë zhvillohen në lidhje me shtetasit e tyre në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.

- b. Për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare) është përgjegjës për të siguruar që hetimet e sigurisë të zhvillohen në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë, me kusht që të zbatohen standardet minimale që janë jo më pak të rrepta se ato të parashikuara në Vendimin e Këshillit 2013/488/BE.

SIGURIA FIZIKE

10. Informacioni i klasifikuar i shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje mund të trajtohet
- në një Secured Area¹ ose Zonë Sigurie; ose
 - në një Administrative Area² ose Zonë Administrative, me kusht që informacioni i klasifikuar të mbrohet përkundrejt aksesit nga individë të paautorizuar.
11. Informacioni i klasifikuar RESTREINT UE/EU RESTRICTED ose I KUFIZUAR ruhet në mobilie të kyçura zyre në një Secured Area ose Zonë Sigurie ose në një Administrative Area ose Zonë Administrative.
12. Informacioni i klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL dhe SECRET UE/EU SECRET ose SEKRET ruhet në kontejnerë sigurie që përputhen me specifikimet e aprovuara nga Pala marrëse. Ato duhet të jenë në një Secured Area ose Zonë Sigurie.
13. Palët garantojnë që zonat në të cilat diskutohet informacioni i klasifikuar SECRET UE/EU SECRET ose SEKRET dhe më lart të jenë të mbrojtura ndaj sulmeve përgjuese pasive dhe aktive.

¹ Zonë Sigurie ka një perimetër dukshëm të kufizuar dhe të mbrojtur, nëpërmjet të cilit kontrollohen të gjitha hyrjet dhe daljet nëpërmjet një leje kalimi ose sistemi të identifikimit të personit. Aksesit i pashoqëruar u lejohe vetëm atyre individëve që kanë leje sigurie dhe të autorizuar posaçërisht për të hyrë në zonë mbi bazën e nevojës së tyre njohje. Të gjithë individët e tjerë do të shoqërohen në çdo rrethanë ose tu nënshtrohen kontrolleve të barasvlershme.

² Zonë Administrative ka një perimetër dukshëm të kufizuar që u mundëson individëve dhe, sipas rastit, automjeteve, që të kontrollohen. Aksesit i pashoqëruar në këto zona u lejohe vetëm atyre individëve që janë të autorizuar posaçërisht nga autoritetet kompetente dhe të gjithë individët e tjerë do të shoqërohen në çdo rrethanë ose tu nënshtrohen kontrolleve të barasvlershme.

MENAXHIMI I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Regjistrimi

14. Në Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit, Komisionin Europian, Shërbimin Europian për Shërbimin e Jashtëm dhe Republikën e Shqipërisë ekziston një sistem regjistrimi për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar sipas Marrëveshjes.
15. Sistemet e regjistrimit shënojnë të gjithë informacionin e klasifikuar që deklarohet dhe merret nga Palët sipas Marrëveshjes. Informacioni i klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL dhe më lart regjistrohet për qëllime sigurie në mënyrë që të evidentohet i gjithë cikli i jetës së këtij informacioni, duke përfshirë marrjen, shpërndarjen, kthimin ose asgjësimin.
16. Për qëllimet e Nenit 10(1) të Marrëveshjes, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të BE-së do të jetë Regjistri Qendror për informacionin shqiptar të klasifikuar të dhënë BE-së dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoritet i Sigurimit Kombëtar) në Republikën e Shqipërisë do të jetë Regjistri Qendror i informacionit të klasifikuar të BE-së që i jepet Republikës së Shqipërisë.
17. Përjashtimisht, për qëllimin e Nenit 10(2), korrespondenca mund të adresohet dhe bëhet e aksesueshme tek marrës të përcaktuar posaçërisht. Një korrespondencë e tillë do të transmetohet nëpërmjet regjistrave që janë ngritur si më poshtë:
 - a. Nëse i adresohet Këshillit Europian, Këshillit të BE-së ose Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të BE-së: Regjistri Qendror i Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të BE-së;
 - b. Nëse i adresohet Komisionit Europian: Regjistri i Përgjithshëm i Sekretariatit të Komisionit Europian;
 - c. Nëse i adresohet Përfaqësuesit të Lartë ose Shërbimit Europian me Veprim të Jashtëm: Regjistri i Shërbimit Europian me Veprim të Jashtëm.
18. Pika e hyrjes së informacionit të klasifikuar të dhënë Republikës së Shqipërisë do të jetë Misioni i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Kopjet dhe përkthimet

19. Kopjet ose përkthimet e informacionit të klasifikuar RESTREINT UE/EU RESTRICTED or I KUFIZUAR dhe CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL mund të bëhen nga Pala marrëse pa kërkuar pëlqimin e Palës dhënëse, përveç nëse janë caktuar kushte ose tregues për kopjimin dhe përkthimin. Informacioni i klasifikuar SECRET UE/EU SECRET or SEKRET dhe më lart vetëm mund të kopjohet ose përkthehet me pëlqimin paraprak me shkrim të Palës dhënëse.
20. Në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e Palës përkatëse, çdo kopje dhe përkthim do të trajtohet si origjinal. Nëse informacioni i klasifikuar riprodhohet ose përkthehet, të gjitha shënjimet, kushtet dhe treguesit origjinalë të tij gjithashtu riprodhohen.

Transmetimi the transporti i informacionit të klasifikuar

21. Informacioni i klasifikuar në formatin e ekzemplarëve në letër dhe mjetet ruajtëse kompjuterike portative mund të shkëmbehen vetëm nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:
 - a. korrierëve ushtarakë ose diplomatikë;
 - b. transportim dorazi, me kusht që:
 - i. paketa të ketë një vulë zyrtare ose paketohet në mënyrë të tillë që të tregojë që është një dërgesë zyrtare dhe nuk duhet të kalojë tek kontrolli i klientëve ose sigurisë;
 - ii. dokumentet ose media që ka informacion të klasifikuar të transferohet në zarfe të dyfishtë dhe të vulosur, kur zarfi i brendshëm të ketë vetëm klasifikimin e dokumenteve ose mjetit tjetër dhe adresën e marrësit të synuar, dhe zarfi i jashtëm të ketë adresën e marrësit të synuar, adresën e dërguesit dhe numrin e protokollit, sipas rastit;
 - iii. nuk ka ndonjë tregues në paketimin e jashtëm të dërgesave që përmbajtja është e klasifikuar;
 - iv. individët mbajnë një certifikatë korrieri që identifikon paketën dhe i autorizon ata të mbartin paketën;
 - v. informacioni i klasifikuar nuk lejon posedimin e mbajtësit;
 - vi. informacioni i klasifikuar nuk hapet *en route* ose lexohet në mjedise publike; dhe

- vii. individët udhëzohen në lidhje me përgjegjësitë e tyre për sigurinë dhe, nëse mbartin informacion të klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose (KONFIDENCIAL) dhe më lart, kanë lejen e përshtatshme të sigurisë.

Ulja e nivelit të sigurisë dhe deklasifikimi

22. Në pajtim me Nenin 5(b) të Marrëveshjes, autoriteti kompetent i sigurisë i Palës marrëse garanton që informacionit të klasifikuar të mos i ulet niveli i sigurisë dhe/ose të deklasifikohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës dhënëse.

Asgjësimi

23. Nëse informacioni i klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL asgjësohet, në regjistrin përkatës bëhet një shënim dhe lëshohet një certifikatë asgjësimi. Nëse informacioni i klasifikuar SECRET UE/EU SECRET ose SEKRET dhe më lart asgjësohet, asgjësimi asistohet nga një person me leje të përshtatshme sigurie, në regjistrin përkatës bëhet një shënim dhe lëshohet një certifikatë asgjësimi. Certifikatat e asgjësimit ruhen të paktën pesë vjet.
24. Planet e emergjencës marrin parasysh nevojën për të mbrojtur informacionin e klasifikuar të shkëmbyer sipas Marrëveshjes gjatë situatave emergjente me qëllim që të shmangët aksesin, deklarimi i paautorizuar ose humbja e integritetit apo disponueshmërisë. Pala dhënëse informohet në rast se është bërë asgjësimi emergjent i informacionit të klasifikuar të regjistruar të marrë sipas Marrëveshjes.

Humbja ose komprometimi i informacionit të klasifikuar

25. Kurdoherë që zbulohet apo dyshohet një komprometim i informacionit të klasifikuar të marrë nga Pala dhënëse, përgatitet një raport fillestar që jep hollësitë e humbjes ose komprometimit dhe i dërgohet:
- nga GSCDSS, HR.DS-ja e Komisionit ose EEAS BA.SI drejtuar Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurimit Kombëtar) të Republikës së Shqipërisë për informacionin e klasifikuar të marrë nga Republika e Shqipërisë;
 - nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurimit Kombëtar) të Republikës së Shqipërisë drejtuar GSCDSS-së, HR.DS-së e Komisionit ose EEAS

BA.SI për informacionin e klasifikuar të marrë nga BE-ja;

26. Në lidhje me humbjen ose komprometimin, zhvillohet një hetim në rrethanat përkatëse. Me përfundimin e hetimit, autoritetit(eve) kompetent të sigurisë së Palës dhënëse i paraqitet një raport përfundimtar. Në përfundim të hetimit, merren masat kompesuese, korrigjuese ose ligjore, sipas rastit, dhe në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të Palës ku ka ndodhur incidenti.

Vizitat vlerësuese dhe kontrollet e brendshme

27. Pjesëmarrësit lehtësojnë vizitat reciproke për vlerësimin e përmendur në Nenin 9 të Marrëveshjes për të garantuar që informacioni i shkëmbyer sipas Marrëveshjes ruhet si duhet. Këto vizita do të zhvillohen si pjesë e një procesi të miratuar bashkërisht.
28. Pjesëmarrësit janë përgjegjës për zbatimin e standardeve të përshkruara në këtë masë zbatuese. Secili Pjesëmarrës do të zhvillojë kontrolle të brendshme për të verifikuar marrjen e masave të nevojshme për sigurinë.

MBROJTJA E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR TË TRAJTUAR NË CIS

29. Të gjitha sistemet e komunikimit dhe informacionit të Republikës së Shqipërisë që trajtojnë informacion të klasifikuar të BE-së kërkojnë akreditimin e një autoriteti shqiptar për akreditimin e sigurisë.
30. Të gjitha sistemet e komunikimit dhe informacionit të BE-së që trajtojnë informacion të klasifikuar të Republikës së Shqipërisë kërkojnë akreditimin e një autoriteti të përshtatshëm të BE-së për akreditimin e sigurisë.
31. Informacioni i klasifikuar i transmetuar me mjete elektronike do të kodohet me produktet koduese të rena dakord bashkërisht.

SIGURIA INDUSTRIALE

32. Nëse informacioni i klasifikuar i marrë nga Pala dhënëse i deklarohet ose i jepet kontraktorëve të Palës marrëse në pajtim me Nenin 6(5) të Marrëveshjes, Pala marrëse

garanton që këta kontraktorë kanë marrë përsipër, si pjesë e detyrimeve të tyre kontraktuale, të ofrojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së informacionit të klasifikuar. Pala marrëse, në pajtim me ligjet, rregullat dhe rregulloret e zbatueshme garanton që kontraktorët që trajtojnë dhe ruajnë informacionin e klasifikuar CONFIDENTIEL UE/EU CONFIDENTIAL ose KONFIDENCIAL dhe më lart në mjediset e tyre, të kenë një Facility Security Clearance (FSC) ose Certifikatë e Sigurimit Industrial (CSI), që është lëshuar bazuar në shkakun e standardeve minimale që janë jo më pak të rrepta se ato që parashikohen në Vendimin e Këshillit 2013/488/BE. Pala marrëse garanton gjithashtu që personeli i kontraktorëve që trajton një informacion të tillë të ketë një CSP të përshtatshme.

NDËRLIDHJA DHE RISHIKIMI

33. Pjesëmarrësit monitorojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar sipas Marrëveshjes.
34. Çdo modifikim i kësaj Mase Zbatuese do të miratohet bashkërisht nga Pjesëmarrësit dhe aprovet nga Komiteti i Sigurisë së Këshillit dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoritet i Sigurimit Kombëtar) i Republikës së Shqipërisë.